RADIO TELEVIZIONI I KOSOVËS
RADIO TELEVIZIJA KOSOVA
RADIO TELEVISION OF KOSOVO
RADIO
Nr. 0093/23
Data 02.10.2023
PRISHTINË

Bordi i Radiotelevizionit të Kosovës, në mbështetje të nenit 29 paragrafi 2.15 të Ligjit nr 04/L-046 për Radiotelevizionin e Kosovës, nenit 85 paragrafi 1.4, nenit 86 paragrafi 1, nënparagrafi 1.1 i Ligjit nr.03/L-212 të Punës, nenit 17 paragrafi 15 i Statutit të RTK-së, për shkelje të rënda, të nenit 18 paragrafi 2 dhe 3 i Ligjit për RTK-në, paragrafit 1.3 të Standardeve Profesionale dhe Parimet Etike të Gazetarisë në programet e RTK-së, si dhe në bazë të propozimit të datës 30.09.2023 të Drejtorit të Përgjithshëm, në mbledhjen e jashtëzakonshme të datës 30.09.2023 me 10 vota për dhe asnjë kundër merr:

Vendim

I. Drejtori i kanalit televiziv në gjuhën serbe, z. Zheljko Tvrdisic **ËSHTË PËRGJEGJËS** për shkelje të rënda ligjore të parapara në nenin 18 paragrafi 2 dhe 3 i Ligjit nr. 04/L-046 për RTK-në, paragrafit 1.3 të Standardeve Profesionale dhe Parimet Etike të Gazetarisë në programet e RTK-së;

II. Për shkelje të lartcekura, z. Zheljko Tvrdisic suspendohet nga detyra për një afat prej 30 ditë, me pagesë në lartësi prej 50%.

III. Vendimi hyn në fuqi më datë 30.09.2023.

Arsyetim

Më datë 24 shtator 2023 përmes emailit, kryetari i Bordit Radiotelevizionit të Kosovës ka kërkuar nga Drejtori i Përgjithshëm i RTK-së, respektivisht nga të gjitha njësitë programore që të kenë kujdes të shtuar dhe vigjilencë në raport me situatën në veri të datës 24 shtator 2023, si dhe të raportohet me profesionalizëm, me qëllim të paanshmërisë si vlerë themelore e të gjithë programeve të RTK-së, i cili duke qenë transmetues publik ka për mision informimin objektiv të publikut, gjithmonë sipas akteve ligjore që rregullojnë këtë fushë.

Drejtori i kanalit televiziv në gjuhën serbe z. Zheljko Tvrdisic, ka dështuar në realizimin e detyrave të punës, duke neglizhuar përgjegjësitë të parapara me kontratën e tij të punës, me transmetimin e një kronike më datë 28.09.2023 në kanalin televiziv në gjuhën serbe RTK 2-TV, kronikë e cila në mënyrë direkte dhe indirekte mbështetë aktin terrorist në veri të Republikës të Kosovës të datës 24 Shtator 2023.

Ky akt nga instancat vendore dhe ndërkombëtare është trajtuar, përkatësisht emëruar si sulm terrorist. Një kronikë e tillë nxitë urrejtje ndëretnike dhe dëmton harmoninë në mes komuniteteve që jetojnë në Republikën e Kosovës. Ndër të tjera, kronika flet edhe për respektimin e ditës së zisë të shpallur nga shteti i Serbisë, duke u zbatuar në komunën e Graqanicës, e cila ndodhet në territorin e Republikës së Kosovës.

Kronika televizive e transmetuar në edicionin qendror të lajmeve në datën e lartcekur dhe e publikuar në kanalin e RTK2 në youtube është thellësisht tendencioze dhe joprofesionale sepse i mungon e vërteta gazetareske si për ngjarjen të cilës i referohet, pra sulmit terrorist të 24 shtatorit, po ashtu edhe për kontekstin shoqëror dhe politik në të cilin jetojnë qytetarët e Kosovës pa dallim etnie. Si e tillë ajo në tërësinë e saj dominohet nga narrativa propagandistike e pushtetit në Serbi i cili synon ta paraqesë Kosovën si vend jo stabil dhe ku komunitetet pakicë terrorizohen . Për më tepër, në kronikën e transmetuar, njëri nga qytetarët e intervistuar i referohet shtetit të Republikës së Kosovës me termin "Kosovo i metohija", term tendencioz politik që nuk përfillë rendin juridik kushtetues të shtetit sovran, i përkufizuar në Nenin 1 të Kushtetutës së Republikës të Kosovës, me emërtim Republikë e Kosovës.

Si rrjedhojë, nga faktet e prezantuara, duke u bazuar në përgjegjësitë dhe kompetencat e tij, Bordi i RTK-me propozimin e datës 30.09.2023 të Drejtorit të Përgjithshëm, vendos që të njëjtin ta suspendojë nga puna për një afat prej 30 ditë.

Në bazë të asaj që u cek më lartë është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.

Arta Berisha

Nënkryetare e Bordit të RTK-së

Nga një kopje e vendimit i dorëzohet:

- z. Zheljo Tvrdisic;

- Sekretariatit të Bordit ;

-Drejtorit të përgjithshëm të RTK-së

- Shërbimit të administratës dhe burimeve njerëzore në RTK.

KËSHILLË JURIDKE: *Kundër këtij vendimi pala mund të paraqes padi, brenda afatit prej një muaji nga dita e pranimit në Gjykatën Themelore në Prishtinë.*